

PAULO COELHO

HIPÍ
ROMAN

BOTIMET TOENA





*Libra nga Paulo Coelho,
prej Shtëpisë Botuese TOENA*

- ☐ Alkimisti
- ☐ Mali i pestë
- ☐ Veronika vendos të vdesë
- ☐ Djalli dhe zonjusha Prym
- ☐ Pelegrini i Kompostelës
- ☐ Manuali i luftëtarit të dritës
- ☐ Njëmbëdhjetë minuta
- ☐ Zahiri
- ☐ Shtriga e Portobelos
- ☐ Buzë lumit Piedra u ula dhe qava
- ☐ Fitimtari është i vetëm
- ☐ Brida
- ☐ Alef
- ☐ Shkelja e kurorës
- ☐ Dorëshkrimi i gjetur në Akra
- ☐ Spiunia
- ☐ Hipi

PAULO COELHO

HIPÍ

roman

Përktheu
Erion Gjatolli

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Titulli në origjinal: Hippie

Ky libër u botua sipas marrëveshjes me Sant Jordi Asociados
Agencia Literaria S. L. U., Barcelona (Spain).

www.santjordi-asociados.com

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-39-8

© Harta në f. 136 dhe 137 Christina Oiticica

© 2018 Paulo Coelho

<http://paulocoelhoblog.com>

© në shqip Botimet Toena 2019

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi
me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim
të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

*Kushtuar Kabirit, Rumiut, Tagores, Palit të Tarsosit,
Hafezit, që më shoqërojnë prej ditës kur i zbulova, që
kanë shkruar atë pjesë të jetës sime që rrëfej në këtë libër,
shpesh me fjalët e tyre.*

*O Mari, ngjizur pa mëkat,
lutu për ne që Ty të drejtohem.
Amin*

“Megjithatë, e njoftuan: 'Nëna jote dhe vëllezërit e tu janë jashtë dhe duan të të shohin'.

Ai u përgjigj: 'Nëna ime dhe vëllezërit e mi janë këta që e dëgjojnë fjalën e Perëndisë dhe e zbatojnë atë'.”

Luka, 8, 20-21

“Pandehe se udhëtimit tim i kish ardhur fundi,
tani që fuqitë më kishin shteruar.
Pandehe se rruga përpara meje ishte mbyllur
e rezervat kishin mbaruar.
Pandehe se ishte koha të gjeja prehje
në errësirën e mbytur në heshtje.
Por tani kuptoj se fytyrimi yt
për mua ende s’ka sosur.
E, kur fjalët e lodhura më vdirren në buzë,
melodi të reja më lindin në zemër.
E, ku kam humbur gjurmët e shtigjeve të vjetra,
një tokë e re më përshfaqet tok me mrekullitë e saj.”

Rabindranath Tagore, “Pandehe se udhëtimi im...”.

Historitë, që rrëfej në këtë libër, i përkasin përvojës sime personale. Disa ngjarje i kam përmbledhur, kam ndryshuar kronologjinë, emrat dhe tiparet e personazheve: e, gjithsesi, të gjitha kanë ndodhur me të vërtetë. Kam zgjedhur të rrëfej në vetën e tretë, që personazhet të kishin mundësi t'i përshkruanin jetët e tyre.

Në shtatorin e vitit 1970, vetëm dy vende mund të mateshin me shoqi-shoqin në privilegjin për të qenë qendra e botës: kryqëzimi *Piccadilly Circus* në Londër dhe *Sheshi Dam* në Amsterdam. Por jo të gjithë e dinin: kësisoj, po të pyesje kush ishte me të vërtetë qendra e botës, shumë njerëz do të përgjigjeshin: “Shtëpia e Bardhë në Shtetet e Bashkuara”, ose: “Kremlini i Bashkimit Sovjetik”. Më së shumti sepse këta individë informoheshin nga gazetatat, televizionet, radiot - mjete komunikimi në rënie të vazhdueshme dhe që nuk do ta fitonin më atë rëndësi që kishin pasur në kohët kur i kishin shpikur.

Në shtatorin e vitit 1970, biletat e avionit kushtonin shumë e, për rrjedhojë, udhëtimet ishin më së shumti privilegj i elitave. Në të vërtetë nuk ishte kështu për një turmë të jashtëzakonshme të rinjsh dhe të moshuarish, që mediat i përmendnin vetëm për pamjen e jashtme: flokët e gjatë, veshjet shumëngjyrëshe, higjienën e dobët personale - pa dyshim e pavërtetë: por këta të rinj nuk i lexonin gazetatat dhe të rriturit i besonin çdo

lajmi që dilte për të diskredituar një grup njerëzish që konsideroheshin si “kërcënim për shoqërinë dhe moralin”; madje, me lirinë e tyre, me “dashurinë e hapur”, si thuhej asokohe me përbuzje, vinin në rrezik një brez të tërë djemsh e vajzash të mbarë, që synonin vetëm të afirmoheshin në jetë. E, pra, kjo masë gjithnjë e më e numërt të rinjsh kishte një sistem pothuajse të paidentifikueshëm për t’i shpërndarë lajmet.

Kështu, “Gazeta e padukshme” nuk kishte interes të reklamonte, krahasonte ose komentonte modelin e fundit të *Volkswagen*-it, apo ndonjë ilaç të ri rrobash që hidhej në treg. Artikujt hetonin se cilën rrugë do të shkelte ajo turmë të paudhësh, të fëlliqurish, ithtarësh të “dashurisë së hapur”, të veshur si nuk do të guxonte të vishej asnjë qenie njerëzore me sadopak shije e mend në kokë. Vajzat me flokët e lëshuar, apo të mbledhur në gërsheta të trashë, gjithmonë të stolisur me lule, fundet e gjata, bluzat me ngjyra, të veshura detyrimisht pa sytjena, rruaza të të gjitha llojeve; djemtë me flokët e mjekrën e gjatë, xhinset e dalaboje, të ngrëna e të grisura nga të veshurat, përdorim i zgjatur për shkak të çmimit të lartë që kishin në çdo cep të botës, me përjashtim të Shteteve të Bashkuara... Kështu, pra, këta të rinj mblidheshin nëpër lagjet e periferive të varfra dhe vërshonin në zonat e koncerteve në San-Francisko, ose në vende të tjera të ngjashme.

I mblidhte atje “Gazeta e padukshme”, ku shkëmbenin informacione për vendtakimet në qytete

dhe shtete të ndryshme, për mënyrat se si mund të shëtisnin botën pa hipur në autobusë turistikë, ku udhërrëfyesit përshkruanin peizazhin që shihej nga dritaret, të rinjtë mërzhiteshin, ndërsa të moshuarit dremisnin. Kështu, falë informacionit që kalonte gojë më gojë - pra, falë “GP”-së, merrnin vesh ku do mbahej koncerti i radhës ose drejtimin për shtegun e ardhshëm që do të përshkonin. Për këto aventura nuk kishte pengesa financiare, sepse “Biblën” e këtij komuniteti nuk e kishte shkruar Platoni, ose Aristoteli, apo ndonjë autor i famshëm librash me ilustrime, por Arthur Frommer-i. Pa librin e tij “Europa me 5 dollarë në ditë” nuk nisej askush për në Kontinentin e Vjetër. Në ato faqe gjeje një shtrat për të fjetur dhe një vend për të ngrënë, pika me interes, vendtakime dhe hapësira ku luhej muzikë, gjithmonë pa paguar pothuajse asgjë.

Në atë kohë, Frommer-i kishte gabuar vetëm se nuk e kishte shtrirë udhërrëfyesin përtej Europës. A nuk kishte të tjera vende interesante? A nuk kishin filluar të rinjtë të merrnin rrugën edhe për në Indi, e jo më vetëm për në Paris? Frommer-i i plotësoi këto mangësi disa vjet më vonë, por ndërkohë “Gazeta e padukshme” sugjeronte një itinerar që të shpinte në Amerikën e Jugut, drejt Perusë dhe Maçu Piçut, me rregullin për të mos e përhapur fjalën me ata që nuk i qaseshin botës dhe kulturës hipi. Në të kundërt, edhe në këto vende do të mësynin në fare pak kohë “barbarët” e armatosur me aparate fotografike, gati

të dëgjonin shpjegime të stërzgjatura - e sakaq të harruara - për komunitetin e indianëve të Amerikës që ngritën një qytet kaq të fshehur, saqë mund të shihej vetëm nga lart: mundësi fort e pagjasë duke qenë se njerëzit nuk fluturonin.

Për hir të së vërtetës, asokohe qarkullonte edhe një libër tjetër, paçka se nuk kishte popullaritetin e udhërrëfyesit të Frommer-it: ishte “Bibla” e atyre që kishin rrahur rrugë e përvoja të ndryshme në jetë: socializmin, marksizmin dhe anarkinë. Të gjitha këto faza ishin përmbyllur me një zhgënjim të thellë ndaj sistemit që kishin shestuar ata që pretendonin “se pushtetin kudo në botë do ta merrnin medoemos punëtorët”, ose që predikonin se “feja është opiumi i popullit”, autori i një shprehjeje kaq të trashë tregonte qartazi se nuk e njihte aspak popullin, e aq më pak opiumin. Në të vërtetë, këta të rinj me flokë të pakrehur dhe veshje shumëngjyrëshe besonin shumë në Zot - a në perëndi, në perëndesha, engjëj dhe entitete të tjera të mbinatyrshme. Vetëm një problem kishte ky libër i famshëm, me titull “Mëngjesi i magjistarëve”, shkruar nga francezi Louis Pauwels dhe sovjetiku me origjinë hebreje, Jacques Bergier, eksplorues i palodhur i botës së magjisë: thoshte të kundërtën e pamfleteve politike që këta të rinj kishin pranuar deri atëherë, pohonte se në botë kishte gjëra të jashtëzakonshme, se ende ekzistonin alkimistë, magjistarë, katarë, tempullarë. Edhe shpërndarja e librit ishte shumë e kufizuar, për shkak të koston

së lartë dhe diskrimuese të vëllimit. Gjithsesi, nëse Maçu Piçu tërhiqte mijëra të rinj nga e gjithë bota (në fakt, nga e gjithë bota është disi e ekzagjeruar, sepse të rinjtë sovjetikë nuk kishin mundësi të dilnin jashtë shtetit), itinerari i sugjeruar nga dy shkrimtarët kërkonte angazhim edhe më të madh.

Të rinjtë e mbledhur nga të katra anët e botës, që kishin fatin të zotëronin atë pasuri të paçmueshme që quhej “pasaportë”, takoheshin përgjatë të ashtuquajturave “shtigje *hipie*”. Askush s’ia dinte kuptimin e saktë fjalës “*hipi*”, por nuk kishte fort rëndësi. Mund të kishte kuptimin e një “fisi të madh pa udhëheqës”, ose të “pacifistëve të përjashtuar”, ose çfarëdo përkufizimi që të përfshinte veçoritë e përshtuara në fillim të këtij kapitulli.

Pasaportat - ato libreza të vogla që lëshonte shteti e që zakonisht ruheshin me një çantë të varur në rrip bashkë me paratë (pak apo shumë nuk kishte rëndësi), kishin dy qëllime. Së pari, të lejonin të kaloje kufirin, veç rasteve kur policët ndalonin ndonjë udhëtar për shkak të ndikimit të medias, sepse nuk ishin të mësuar me ato veshje, me flokët e stolisur me lule, me varëset dhe sjelljen që i bënte të dukeshin si në ekstazë të përhershme - një ekstazë që i vishej, padrejtësisht, disa drogave “djallëzore” që shumë të rinj, kështu shkruanin gazetat, i merrnin në doza gjithnjë e më të mëdha.

Së dyti, pasaporta të vinte në ndihmë në situata ekstreme, si për shembull, nëse mbeteshe pa parà dhe

nuk kishe kujt t'ia kërkoje. Në këto raste, “Gazeta e padukshme” jepte informacion të hollësishëm se ku mund të shiteshin pasaporta. Çmimi ndryshonte në varësi të shtetit: një pasaportë e Suedisë, vendi ku të gjithë kanë lindur të gjatë, biondë e me sy të çelët, vlente relativisht pak, duke qenë se tregu i saj kufizohej te njerëzit me po ato tipare. Ndërsa një pasaportë braziliane ishte një thesar i vogël, duke qenë se brazilianët nuk ishin vetëm të gjatë dhe biondë me sy të çelët, por edhe zezakë me shtat të çfarëdoshëm, me sy të errët, aziatikë sybajame, por edhe mulatë, indianë, arabë, hebrenj; me pak fjalë, kishte treg më se të gjerë që e bënte një nga pasaportat më të lakmuara në planet.

Me të shitur pasaportën, mbajtësi shkonte në konsullatën e vendit të tij dhe, duke u hequr si i trembur dhe i mërzhitur, shpjegonte se e kishin sulmuar dhe se i kishin vjedhur çdo gjë që kishte me vete. Domethënë, kishte mbetur pa parà dhe pa pasaportë. Konsullatat e shteteve më të pasura i lëshonin pasaportë të re dhe i jepnin një biletë avioni për t'u kthyer në vendin e origjinës. Vetëm se udhëtari e refuzonte atë mundësi duke thënë: “Dikush më detyrohet një shumë të madhe, nuk iki pa i marrë paratë e mia”. Vendet më të varfra, shpesh të qeverisura nga regjime të rrepta ushtarake, silleshin ndryshe: punonjësit e konsullatës i merrnin në pyetje udhëtarët si të ishin në hetuesi, për t'u siguruar se aplikanti nuk ishte në listën e “terroristëve” të kërkuar për aktivitete armiqësore

ndaj shtetit. Pasi verifikonin se djali apo vajza nuk kishte precedentë penalë, edhe pse me pahir, i lëshonin dokumentin e ri. Për biletë kthimi nuk bëhej fjalë, sepse nuk kishin ndonjë interes që këto qenie të shthurura të ndikonin negativisht te brezat e edukuar për të respektuar Perëndinë, familjen dhe pronën.

Pas Maçu Piçut, itinerari i drejtonte të rinjtë për në Tiahuanaco (Bolivi), e më pas për në Lhasa (Tibet). Këtu ishte më e vështirë të hyje, sepse, sipas “Gazetës së padukshme” po zhvillohej një luftë midis murgjve dhe ushtarëve kinezë. Ishte fjala për një konflikt të pakuptueshëm në Perëndim, por askush nuk do të ndërmernte një udhëtim aq të gjatë për të rënë peng i murgjve ose ushtarëve. Ata që konsideroheshin filozofët e fundit të asaj epoke, grupi *The Beatles*, ishin ndarë pikërisht në prillin e atij viti, pak kohë pasi kishin thënë se dija më e madhe në botë gjendej në Indi. Kaq ishte më se e mjaftueshme që mijëra të rinj të vërshonin atje për të kërkuar kulturë, dituri, mjeshtër jete dhe zotime varfërie, ndriçimin dhe dëshirën të bashkoheshin me “My sweet Lord”-in.

Megjithatë, “Gazeta e padukshme” përhapi lajmin se Maharishi Mahesh Yogi, guruja i njohur i Beatles-ave, ishte përpjekur të kryente marrëdhënie seksuale me aktoren Mia Farrow, pa pëlqimin e saj. Aktorja kishte pasur gjithmonë lidhje sentimentale të trazuara e të palumtura, dhe ishte nisur për në Indi me ftesë të Beatles-ave për të tejkaluar disa trauma, që kishin të

bënin me seksualitetin e saj, dhe që e mundonin prej kohësh.

Veçse karma negative e ndoqi Farrow-n edhe në atë vend paqeje. Ndërsa meditonte në shpellën e Ashramit, guruja e kishte kapur dhe ishte përpjekur të ushtronte dhunë. Meqë Ringo-ja dhe Paul-i ndërkohë ishin kthyer në Angli - i pari, sepse e shoqja nuk pëlqente kuzhinën e vendit dhe tjetri nga bindja se meditimi nuk do t'i bënte hair - Mia shkoi te John-i dhe George-i, dhe u tregoi me ngashërim çfarë kishte ngjarë. Në çast këta bënë gati valixhet dhe kur i Ndriçuari u kërkoi arsye pse po iknin, Lennon-i i dha një përgjigje lapidare:

- A s'ishe ti i Ndriçuari i bythës? Besoj s'e e kupton vetë.

Në shtator të vitit 1970 gratë sundonin botën - ose gratë e reja hipi, më saktë. Burrat e kuptuan se këto gra nuk josheshin nga tendencat e fundit, sepse ishin shumë më të përgatitura se pala mashkullore. Prandaj edhe vendosën të pranonin njëherë e përgjithmonë se kishin nevojë për to, duke u hequr si viktimat dhe duke shprehur një kërkesë të heshtur: "Më mbro, jam i vetëm, pa njeri. Bota më ka harruar dhe dashuria më ka braktisur përgjithmonë". Në këtë pikë, gratë kishin mundësinë të zgjidhnin burrat që donin afër, sigurisht, jo për t'u martuar, vetëm për të kaluar kohën edhe për të ngjëruar pak seks të egër dhe pasional. Kur vinte puna te gjërat e rëndësishme, apo edhe më

të papërfillshme, vendimet i merrnin gratë. Pikërisht për këtë arsye, kur “Gazeta e padukshme” nxori lajmin për ngacmimin seksual të Mia Farrow-s dhe reagimin e Lennon-it, këto gra vendosën menjëherë t’i ndryshonin itineraret.

Kështu lindi një tjetër itinerar hipi, që fillonte nga Amsterdami (Holandë) dhe shkonte deri në Katmandu (Nepal). Udhëtimi me autobus kushtonte më pak se njëqind dollarë dhe kalonte nëpër vende shumë interesante: Turqi, Irak, Iran, Afganistan, Pakistan dhe në disa krahina të Indisë (kuptohet mjaft larg tempullit të Maharishit). Udhëtimi zgjaste tri javë dhe jashtëzakonisht shumë kilometra.

Karla ishte ulur në *Sheshin Dam* dhe hamendësonte se kur do të vinte djali që do ta shoqëronte në këtë aventurë magjike, të paktën kështu e përfytyronte. E kishte lënë punën në Rotterdam dhe kishte ndalur disa makina rrugës për të mbërritur në Amsterdam. Rruga mbante vetëm një orë me tren, por asaj iu desh gati një ditë, sepse donte të kursente sa më shumë. Kishte lexuar për udhëtimin në Nepal, në një nga ato revistat alternative, që shiteshin shumë lirë, por botoheshin me djersën, dashurinë dhe përpjekjet e disa njerëzve që mendonin se kishin diçka të vlefshme për t'i thënë botës.

Një javë kishte kaluar duke pritur dhe tani fillonte të ndihej nervoze. Kishte folur me dhjetëra djem nga vende të ndryshme, që donin thjesht të rrinin atje, në atë shesh që s'ofronte asgjë mbresëlënëse, veç një monumenti falik, që të paktën duhej të frymëzonte sadopak burrëri dhe guxim. Por, jo; asnjëri prej tyre nuk ishte i gatshëm të udhëtonte në toka të panjohura.

Nuk ishte as çështje distance: shumica prej tyre vinin nga Shtetet e Bashkuara, nga Amerika e Jugut, nga Australia dhe vende të tjera, ku udhëtimet me avion kishin çmime të larta dhe paraqisnin vështirësi të shumta për shkak të rregullave të rrepta kufitare; shumë prej tyre, për shkak të shtetësisë, mund t'i ndalonin në kufi dhe t'i detyronin të ktheheshin për në vendin e origjinës pa vënë këmbë në asnjë nga kryeqytetet e botës rinore. Mbërrinin në atë shesh të trishtë, uleshin dhe ndiznin cigaret me marihuanë, të kënaqur që mund t'i pinin në sy të policëve, ndërkohë që me kalimin e ditëve, ua merrnin mendtë sektet dhe kultet e shumta të qytetit. Kështu i harronin edhe këshillat e lodhshme të prindërve: “Shko në universitet, pri flokët, mos na turpëro me dynjanë (*ç'dynja?*), të mos thonë komshinjtë që s'të kemi dhënë edukatë të mirë, s'është muzikë *kjo* që dëgjon ti, tani duhet të gjesh një punë, shiko vëllanë (*ose motrën*): është më i vogël, ama i nxjerr shpenzimet e veta pa na kërkuar gjë neve”.

Larg ankesave të vazhdueshme të familjeve, atje ndiheshin të lirë, Europa ishte vend i sigurt (sa kohë nuk iu shkrepse në mendje të kalonin Perden e Hekurt për të “pushtuar” ndonjë vend komunist). Ishin të kënaqur sepse nga udhëtimet mësonin gjëra që do t'u duheshin në jetë, paçka se këtë nuk dinin t'ua shpjegonin prindërve.

“E di, babi, ju doni që të studioj, por diplomën e marr kur të dua: tani kam nevojë për përvoja të reja.”

Prindërit e kishin të pamundur ta kuptonin një logjikë të tillë, prandaj të rinjtë detyroheshin të kursenin parë, të shisnin ndonjë send me vlerë dhe të iknin nga shtëpia fshehurazi.

Dakord, tani Karla ishte e rrethuar nga të rinj të lirë dhe të vendosur për të kërkuar përvoja që shumica e njerëzve nuk do të guxonte t’i jetonte. Po, atëherë, pse nuk shkonin në Katmandu me autobus? “Se nuk është Europë atje, - përgjigjeshin të rinjtë në *Sheshin Dam*, - është vend i panjohur.” “Po të na ndodhë gjë mund të shkojmë në konsullatat respektive, që të na kthejnë në vendet tona”, thoshte ajo. (Karla nuk kishte dëgjuar për asnjë rast të tillë, por kështu thoshte legjenda dhe kur legjenda përsëritet pafundësisht, bëhet e vërtetë.)

Kishin kaluar shtatë ditë duke pritur dikë që të bëhej “shoqëruesi” i saj dhe tashmë fillonte të shqetësohej. Paguante për të fjetur në një hotel, ndërkohë që mund të kishte fjetur në *Autobusin Magjik* (kështu quhej mjeti që kushtonte njëqind dollarë dhe bënte mijëra kilometra). Atëherë, një mëngjes hyri në studion e një fallxhoreje, që ia kishin zënë sytë çdo ditë rrugës për te *Sheshi Dam*. Sallën e fallxhores e gjeti bosh, siç e kishte parë gjithmonë, në fakt. Në shtatorin e 1970-s, të gjithë të rinjtë ose kishin, ose po zhvillonin aftësi të mbinatyrshme. Por

Karla ishte vajzë praktike dhe, megjithëse meditonte çdo ditë, ishte e bindur se kishte filluar ta zhvillonte syrin e saj të tretë (një organ i padukshëm në lule të ballit, ishte pa dyshim me këmbë në tokë: deri atëherë ishte pleksur vetëm me djem të gabuar, madje edhe kur intuita e siguronte se ishin më se të përshtatshëm.

Prandaj edhe kishte vendosur t'i drejtohej fallxhores, mbi të gjitha sepse ajo pritje e pafundme (po bëhej java, një përjetësi!), po e detyronte të merrte në konsideratë t'i futej udhëtimit me një shoqëruese vajzë. I kishte peshuar mirë rreziqet e shumta që mund të ndeshin dy vajza që udhëtojnë në vende aspak mikpritëse. Në rastin më të mirë do t'i shihnin vëngër, në rastin më të keq, siç i kishte thënë gjyshja, mund t'i shishnin si “skllave të bardha”, përkufizim me një si vel erotik, që gjithsesi nuk donte ta eksperimentonte te vetja.

Fallxhorja quhej Lejla dhe ishte ndonjë vit më e madhe se Karla. Ishte veshur me të bardha dhe e priti me një përkulje të lehtë dhe me buzëqeshjen engjëlllore të dikujt që jeton në sintoni të plotë me Qenien Supreme (ose thjesht mendoi: “dolën edhe ca pará për qiranë e muajit”). Karla zuri vend dhe fallxhorja e lavdëroi, sepse kishte zgjedhur qendrën energjetike të dhomës. Fillimisht Karla mendoi se e kishte mprehur disi shikimin e syrit të tretë, por nënvetëdiya e paralajmëroi: me siguri ato lavde Lejla

ua thoshte të gjithëve, ose më saktë, të paktëve që i shkelnin në studio.

Sidoqoftë, këto ishin mendime pa rëndësi. Fallxhorja ndezi disa shkopinj temjani, që e theksoi se ia kishin sjellë nga Nepali, por Karla e dinte se me shumë mundësi ishin prodhuar në ndonjë fabrikë aty pranë. Shkopinj të temjanit, bashkë me varëset, këmishët *batik*, xhinglat me lule ose me simbolin e paqes, si dhe shiritat e pëlhurës me frazën “Flower Power”, që ngjiteshin në rroba, ishin një nga industritë më të suksesshme të periudhës. Lejla mori një tufë me letra dhe zuri t’i përziente; më pas iu drejtua Karlës që t’i ndante. Në fund zgjodhi tri letra dhe nisi t’i lexonte sipas zakonit. Karla e ndërpreu.

- S’kam ardhur për këtë punë. Dua të di nëse do të gjej dikë që të vijë me mua tek ai vendi që përmende ti, - dhe i theksoi mirë fjalët “tek ai vendi që përmende ti”, sepse nuk donte të kishte ndonjë pasojë negative te karma e saj; po të kishte thënë “te vendi nga vjen temjani” mund të përfundonte në ndonjë periferi të Amsterdami, atje ku ndodhej fabrika e shkopinjeve, - ... tek ai vendi nga the se vjen temjani.

Lelja buzëqeshi, edhe pse energjia në sallë kishte ndryshuar - përbrenda turfullonte nga inati që vajza kishte ndërprerë një moment aq solemn.

- Po, sigurisht që do të gjesh dikë që të të shoqërojë atje.

(Është detyrë e çdo fallxhori t' u thotë klientëve atë që ata duan të dëgjojnë.)

- Kur?

- Pa u ngrysur dita e nesërme.

U zunë të dyja në befasi dhe mbetën si të mpira.

Për herë të parë, Karla ndjeu se fallxhorja po i thoshte të vërtetën: zëri iu bë më i butë dhe i ngrohtë, sikur t' i vinte nga një dimension tjetër. Ndërsa Lejlën e pllakosi frika. Rrallëherë i ecte puna në këtë mënyrë dhe i druhej ndonjë ndëshkimi nëse depërtonte pa kujdesin e duhur në atë botë që dukej e rreme dhe e vërtetë në të njëjtën kohë. Gjithsesi, çdo natë në lutje kërkonte falje dhe justifikohet: thoshte se mbi këtë tokë, ajo mundohej ta ndihmonte tjetrin, duke ofruar ngushëllim dhe shpresë.

Karla u ngrit menjëherë nga qendra e energjisë, pagoi vetëm gjysmën e tarifës për konsultën dhe u largua me nxitim, që të mos t' i shpëtonte djali që priste prej ditësh. “Pa u ngrysur dita e nesërme”, ishte frazë shumë e vagullt, mund të vinte që atë ditë. Të paktën tani e dinte se dikush do të vinte.

U ul në vendin e zakonshëm në *Sheshin Dam*, hapi librin që po lexonte, që asokohe e njihnin shumë pak veta dhe kjo i jepte autorit të tij statusin e idhullit: “Zoti i unazave”, i J. R. R. Tolkien-it, një sagë që zhvillohej në toka mitike, si ato që donte të vizitonte sa më shpejt edhe Karla. Bëri sikur nuk i dëgjoji të

rinjtë që, herë pas here, e shqetësonin me pyetje idiote, përpjekje të dobëta për të filluar një bisedë edhe më të dobët.

Pauloja dhe argjentinasi kishin rrahur çdo argument të mundshëm bisede dhe tani po e hidhnin shikimin te territoret e sheshta përgjatë rrugës, por mendjen e kishin tjetërkund. Të dy bartnin me vete kujtime, emra, anekdota dhe, mbi të gjitha, një frikë të thellë për atë që mund të ndodhte në kufirin holandez, afro njëzet minuta larg.

Pauloja u mundua t'i fshehë flokët e gjatë nën jakën e xhupit.

- Ta merr mendja se do t'ua hedhësh doganierëve ashtu? - pyeti argjentinasi. - Këtyre kushedi ç'u kanë parë sytë.

Pauloja hoqi dorë dhe e pyeti shokun nëse ishte i shqetësuar.

- Sigurisht, sidomos sepse i kam dy vula holandeze në pasaportë. Mund të thonë që kam ardhur shumë shpesh. Dhe kuptohet ku e kanë hallin pastaj.

Te trafiku i drogës. Por, me sa dinte Pauloja, atje drogat ishin të ligjshme.

- Absolutisht, jo. Opioidet janë të ndaluara. Edhe kokaina. Vetëm LSD-në s'e kontrollojnë dot. Mjafton

të ngjyesh një faqe libri, një copë letre ose stofi, ta presësh në kuadrate të vogla dhe ta shesësh. Gjithsesi, me çfarëdo substance narkotike përfundon në burg.

Paulos iu duk me vend ta mbyllte atë bisedë. Vërtet donte të dinte me patjetër a kishte gjë me vete argjentinasi, por e kishte të qartë se të kesh dijeni të bën edhe ty bashkëpunëtor. E kishin arrestuar një herë, edhe pse ishte i pafajshëm, në një vend që shpallte me të madhe në dyert e të gjitha aeroporteve: “Brazil: duaje, ose lëre”.

Ndodh shpesh që kur përpiqemi të largojmë mendime të këqija, pashmangshmërisht tërheqim energji djallëzore, dhe vetëm sepse e kujtoi atë ngjarje të vitit 1968, Paulos iu shtuan rrahjet e zemrës dhe e përjetoi edhe një herë çdo çast të asaj mbrëmjeje në një restorant në Ponta Grossa, në Paraná - një shtet me nam në Brazil se lëshonte nga ato pasaportat për burra dhe gra me flokë biondë dhe me sy të çelët.

Po kthehej nga udhëtimi i tij i parë në një shteg hipi, asokohe shumë në modë. Ishte me të dashurën: lindur dhe rritur në regjimin komunist në Jugosllavi, njëmbëdhjetë vjet më e madhe në moshë, vajzë e një familjeje aristokrate serbe, tashmë pa privilegje, por që i kishte dhënë arsimim tejet të sofistikuar, prandaj edhe fliste rrjedhshëm katër gjuhë. Në Brazil u martua me një milioner, por e divorcoi kur zbuloi se tashmë i shoqi e konsideronte “plakë” - ishte tridhjetë e tre vjeçe - dhe ishte lidhur me një çupëlinë shtatëmbëdhjetëvjeçare. Gjeti një avokat të nivelit të lartë, që i siguroi një dëmshpërblim kaq të madh, sa të mos kishte më nevojë të punonte asnjë ditë për gjithë jetën. Pauloja dhe e dashura ishin nisur bashkë për në Maçu Piçu me të ashtuquajturin *Treni i vdekjes*, një mjet hekurudhor shumë i ndryshëm nga ata që janë në përdorim sot.

- Pse e quajnë *Treni i vdekjes*? - e kishte pyetur vajza faturistin. - S’më kanë zënë sytë humnera gjatë rrugës.

Pauloja nuk kishte ndonjë interes për përgjigjen.

- Njëherë e një kohë, në këta vagonë transportoheshin të sëmurët me lebër, murtajë dhe viktimat e një epidemie ethesh të verdha, që goditi rajonin e Santa Cruz-it, - u përgjigj burri me uniformë.

- Do t'i kenë dezinfektuar me kujdes vagonët, besoj.

- Natyrisht. Gjithsesi, s'është sëmurur njeri që atëherë. Minatorë vdesin shpesh, por ata e kanë nga silikoza.

Nuk e kishte fjalën për minatorët e krahinës Minas Gerais, në Brazil, por për ata që punonin ditë e natë në minierat e kallajit në Bolivi. Me fjalë të tjera, tani jetonin në një botë të civilizuar dhe treni ishte bërë simbol i përparimit, ku hipnin më së shumti gra me kapelat karakteristike bombé dhe veshjet me ngjyra të ndezura.

Kur arritën në La Paz, kryeqyteti i Bolivisë, 3610 metra mbi nivelin e detit, nuk e ndjenë shumë rrallimin e ajrit. Duke zbritur nga treni vunë re një djalë të veshur me kostumin tradicional të fisit të tij, ulur në stol, plotësisht i çorientuar. E pyetën a ndihej mirë.

- Nuk po mbushem dot me frymë, - iu përgjigj. Dikush tjetër i afroi disa gjethe koke dhe i tha t'i përtypte - ishte zakoni i vjetër që i ndihmonte banorët e zonës të përballeshin me vështirësitë e lartësisë së zonës: gjethet e kokës shiteshin kudo në rrugë dhe në

tregje. Shumë shpejt djali u ndje më mirë dhe iu lut që ta linin vetëm. Ishte nisur edhe ai për në Maçu Piçu.

Receptionistja e hotelit, ku do të flinin, e mori veçmas të dashurën e Paulos, i pëshpëriti disa fjalë dhe pastaj vazhdoi me regjistrimin. Kur u ngjitën në dhomë, përpara se të binin në gjumë, Pauloja e pyeti se çfarë kishte thënë receptionistja.

“Mos bëni seks dy ditët e para.”

Ishte e kuptueshme. E, gjithsesi, asnjëri nuk kishte dëshirë.

Ato dy ditë në La Paz nuk bënë seks dhe nuk e vuajtën shumë *soroche*-n, siç e quanin vendasit mungesën e oksigjenit. Fillimisht menduan se i kishin shpëtuar “sëmundjes së malit” falë efekteve terapeutike të gjetheve të kokës, por nuk ishte kjo arsyeja. *Soroche*-n e ndien nëse ngjitesh në lartësi të mëdha, në kohë shumë të shkurtër, për shembull me avion, ndërkohë që organizmi nuk ka kohë të mësohet. Ndërsa ngjitja me *Trenin e vdekjes* kishte marrë plot shtatë ditë. Është mënyra më e mirë për t’u përshtatur me ndryshimin atmosferik dhe, sigurisht, më e sigurt - si dëshmon edhe një gur varri në aeroportin *Viru Viru* në Santa Cruz de la Sierra, vendosur atje për të nderuar “Pilotët heroikë të avionit *Lloyd Aéreo Boliviano*, që dhanë jetën në krye të detyrës”.

Në La Paz u ndeshën me hipitë e parë: një fis global i vetëdijshëm për përgjegjësitë e përbashkëta dhe solidaritetin reciprok, që identifikohet me simbolin e famshëm mesjetar, disi të përshtatur, që shumë shpejt

pushtoi gjithë botën. Në Bolivi, një vend ku të gjithë visheshin me mantele, jelekë, xhaketa të trasha me ngjyra të ndezura, ishte vërtet e pamundur të dalloje të rinjtë alternativë pa ndihmën e asaj embleme të qepur në xhaketë ose në pantallona.



Veç disa individëve të padepërtueshëm, hipitë e vërtetë ishin dy gjermanë dhe një kanadeze. Meqë e dashura e Paulos fliste gjermanisht, e ftuan menjëherë për një shëtitje në qytet, ndërsa Pauloja dhe kanadezja mbetën vetëm, pa asnjë argument bisede. Kur tre “eksploruesit” u kthyen gjysmë ore më vonë, u vendos të niseshin sa më parë - s’kishte kuptim të harxhonin parà të tjera në kryeqytet. Do të shkonin në liqenin Titikaka - më i larti në botë - do ta përshkonin me varkë dhe do të dilnin në territor peruan, për të marrë më pas drejt Maçu Piçut.

Grupi do ta kishte ndjekur planin fillestar, sikur në krahun tjetër të liqenit Titikaka të mos kishte ndeshur një monument të lashtë, të njohur si Porta e Diellit. Mbledhur rreth monumentit, panë disa të rinj hipi, kapur dorë për dore, që dukej sikur ishin zhytur në një lloj rituali. Pauloja dhe të tjerët donin të merrnin pjesë, por në të njëjtën kohë kishin drojë mos e ndërprisnin ceremoninë.

Një vajzë i vuri re dhe me një shenjë të kokës i ftoi të bashkoheshin me grupin. U ulën të katërt pranë njëri-tjetrit.

Nuk kishte nevojë të shpjegonin pse kishin ardhur: domethënia e portës ishte më se e qartë. Guri kishte një plasaritje në traversën e sipërme, në të djathtë, me gjasa e shkaktuar nga ndonjë rrufe, ndërsa arkitrau ishte një mrekulli, me basorelieve që tregonin histori të një kohe tashmë të harruar, por ende të pranishme, ngjarje që kërkonin të kujtoheshin dhe zbuloheshin sërish. Porta ishte nxjerrë nga një bllok i vetëm andeziti dhe në trarëzimin e sipërm dalloheshin

simbolet e një kulture që, si thoshin vendasit, do të tregonte rrugën për të rindërtuar botën në rast se lakmia e njeriut do ta shkatërronte. Përmes të çarave të portës, duke parë në largësi liqenin Titikaka, Pauloja u përlot: iu duk sikur u bë njësh me ata që e kishin ndërtuar, njerëz që i kishin braktisur ato vende pa e përfunduar punën, nga droja se dikush ose diçka do të vinte t'i pengonte. Vajza që i kishte ftuar t'i bashkoheshin rrethit buzëqeshi; edhe ajo e kishte shikimin e turbulluar nga lotët. Gjithë të tjerët i mbanin sytë e mbyllur, përpiqeshin të komuniknin me paraardhësit dhe të kuptonin, gjithsesi pa dashur ta shuanin misterin, se çfarë i kishte mbledhur në atë vend.

Ata që duan të depërtojnë sekretet e artit të magjisë duhet ta fillojnë rrugëtimin duke vështuar ç'kanë përreth. Perëndia u ka vënë përballë njerëzve gjithë çka donte t'u tregonte. Kjo është rruga e njohur si Tradita e Diellit.

Tradita e Diellit u përket të gjithëve; jo vetëm njerëzve të urtë a të dëlirë, por njerëzve të zakonshëm. Energjia dhe fuqitë gjenden te gjërat më të vogla që njeriu has në rrugën e tij; patjetër, bota është burimi më i madh i të mësuarit, Dashuria Supreme e di se ti ekziston dhe kujdeset të të mësojë gjithçka që duhet të dish.

Rrinin të gjithë në heshtje, gati për të rrokur diçka që s'mund ta identifikonin, por që e dinin se ishte e vërteta. Një nga vajzat ia mori një

këngë në një gjuhë që Pauloja nuk e kuptonte. Një djalë, ndoshta më i madhi në moshë, u ngrit në këmbë, hapi krahët dhe tha një lutje:

*Zoti të dhëntë
Një ylber për çdo stuhi,
Një buzëqeshje për çdo lot,
Një bekim për çdo vështirësi,
Një mik për çdo çast vetmie,
Një përgjigje për çdo lutje.*

Në atë çast u dëgjua sirena e një anijeje: bëhej fjalë për një anije të ndërtuar në Angli, e çmontuar dhe transportuar më pas deri në Kili. Ndërsa pjesët i kishin ngjitur me mushka deri në 3800 metrat e lartësisë së liqenit.

Hipën të gjithë në drejtim të qytetit të lashtë të Maçu Piçut.

Kaluan atje disa ditë të paharrueshme - zhytur në një botë thuajse të lashtë. Rrallëherë turistët shkonin aq larg: vetëm krijesat e përzgjedhura të Perëndisë, njerëzit me të vërtetë të lirë dhe të gatshëm për t'u përballur me të panjohurën, mund të jetonin përvoja të tilla.

Fjetën në disa ndërtesa të braktisura, pa çati, duke kundruar yjet; bënë dashuri; hëngrën ushqimet që kishin marrë me vete; u lanë lakuriqë në lumin që vërshonte teposhtë malit; hamendësuan me orë të tëra se Perënditë inkase kishin qenë astronautë të zbritur në Tokë pikërisht në ato troje. Kishin lexuar të gjithë

të njëjtin libër të Erich von Däniken-it, një autor zviceran që besonte se vizatimet e banorëve të lashtë të krahinës paraqisnin udhëtarë qiellorë; kishin lexuar edhe Lobsang Rampa-n, murgun tibetian, që fliste për syrin e tretë, derisa një ditë një anglez i tregoi grupit të mbledhur në qendrën e Maçu Piçut se murgu i famshëm quhej në të vërtetë Cyril Henry Hoskin, nuk e njihte gjuhën tibetiane dhe s’kishte shkelur ndonjëherë në asnjë manastir aziatik.

Një zhgënjim i thellë e pllakosi të gjithë grupin; mbi të gjitha sepse, ashtu si edhe Pauloja, të gjithë ishin të bindur se kishin vërtet diçka diku midis syve, ai syri i tretë që lidhej me gjëndrën pineale, ndonëse kësaj të fundit shkencëtarët ende nuk ia kishin zbuluar dobinë. Kështu, pra, syri i tretë ekzistonte me të vërtetë - paçka se nuk përkonte me interpretimin e Lobsang “Cyril Henry Hoskin” Rampa-s.

Mëngjesin e ditës së tretë, e dashura e Paulos vendosi të kthehej, por vendosi gjithashtu - pa lënë vend për diskutim - se Pauloja duhej ta shoqëronte. U nisën pa gdhirë dita, pa u përshëndetur me askënd e pa kthyer kokën prapa, ndërsa grupin e lanë në gjumë. Iu deshën dy ditë për të zbritur përgjatë krahut lindor të vargmalit, me një autobus të mbushur me njerëz, kafshë shtëpiake, ushqim dhe produkte artizanale. Pauloja e shfrytëzoi rastin për të blerë një trastë me ngjyra të ndezura, që mund ta paloste dhe ta mbante në çantën e shpinës. Gjithashtu vendosi se nuk do

të bënte më kurrë me autobus rrugë që mbanin më shumë se një ditë.

Nga Lima udhëtuan me makina të rastit deri në Santiago. Bota dukej më pak e rrezikshme në ato kohëra, shoferët ndaleshin për të marrë njerëz në makinë, edhe pse çiftit i druheshin disi për shkak të veshjes. Në Santiago, pasi fjetën mirë natën e parë, i kërkuan një djali, që e kishin takuar në një lokal, t'iu vizatonte në hartë udhëzimet për të kapërcyer vargmalin duke përshkuar qafën e Cumbre-s, që lidhte Kilin me Argjentinën. Vazhduan drejt Brazilit - gjithmonë duke ndalur makina të rastësishme, duke qenë se e dashura e Paulos mendonte se ato pak para që u kishin mbetur, mund t'u duheshin nëse iu dilte ndonjë problem shëndetësor; vajza ishte gjithmonë e kujdesshme, gjithmonë e përgjegjshme, gjithmonë bijë e një edukimi komunist, edukim që nuk e lejonte në asnjë çast të rrinte plotësisht e qetë.

Në Brazil, në shtetin ku lëshoheshin shumica e atyre pasaportave për njerëz biondë dhe me sy të çelët, me sugjerim të vajzës, vendosën të ndalonin pak më gjatë.

- Shkojmë në Vila Velha: thonë që është vend fantastik.

Nuk kishin si ta parashikonin makthin që i priste.

Nuk mund ta dinin sa shumë po i afroheshin ferrit.

Nuk ishin të përgatitur për atë që do t'u ndodhte.

Kishin qenë në vende të mrekullueshme, unike, edhe pse që në ato kohë kishte shenja se në të

ardhmen do të ndryshonin dhe do të shkatërroheshin nga hordhia e turistëve, që e kishin mendjen vetëm të blinin dhe të bënin krahasime me vendin e tyre. Gjithsesi, toni i vajzës nuk linte vend për diskutim: nuk kishte pikëpyetje në fund të fjalisë - faktikisht, ajo thjesht po e njoftonte se çfarë do të bënin në vazhdim.

“Shkojmë në Vila Velha, patjetër”, mendoj Pauloja. Vend fantastik, me skulptura natyrore mbresëlënëse, të gdhendura nga era. Një oazë turistike, që qyteti më i afërt e reklamonte fuqishëm, madje duke shpenzuar shifra jashtëzakonisht të larta. Të gjithë e dinin që Vila Velha ekzistonte, por një pjesë - më pak e informuar - vazhdonte rrugën deri te plazhet e shtetit të *Espírito Santo*-s, pa ndaluar në Ponta Grossa. Të tjerë mendonin se ishte vërtet vend interesant, por u dukej se nuk ia vlente të bënin gjithë atë rrugë.

Pauloja dhe e dashura ishin vizitorët e vetëm dhe u mrekulluan nga mënyrën sesi natyra kishte skalitur gurët për t'u dhënë formën e kupës, breshkës apo devesë: ose më saktë, nga mënyra se si njeriu kërkon t'i vërë emër gjithçkaje - edhe kur deveja në fjalë atij i dukej si portokall, ndërsa vajzës si shegë. Sidoqoftë, ndryshe nga format më rigoroze që kishin parë në Tiahuanaco, këto “skulptura” ranore ishin të hapura për çfarëdolloj interpretimi.

Pas vizitës në park, ndalën një makinë dhe shkuan deri në qytetin më të afërt. Meqenëse shumë shpejt do të ktheheshin në shtëpi, vajza vendosi - ajo vendoste gjithmonë, në fakt - që për herë të parë pas shumë javësh të flinin në një hotel të këndshëm dhe të hanin mish për darkë. Që kur ishin nisur nga La Pazi, nuk kishin ngrënë mish, sepse në atë zonë kushtonte shumë. U regjistruan në një hotel të mirë, bënë një banjë, bënë dashuri; më pas zbritën në sallon, me mendimin për të pyetur se ku mund të hanin mish të mirë me

racione të bollshme, siç e donte *rodizio*-ja tradicionale braziliene.

Po prisnin recepsionistin kur iu afruan dy burra dhe, në mënyrë të vrazhdë, u thanë t'i ndiqnin jashtë hotelit. Të dy i mbanin duart në xhepa, në atë pozicion që tregon qartë se po shtrëngojnë një armë.

- Mos bëni ndonjë hata, - tha e dashura e Paulos, e bindur se ishin dy hajdutë. - Kam një unazë me diamant në dhomë...

Nuk e lanë ta mbaronte fjalinë. I kapën për krahu, i shtynë jashtë dhe i ndanë. Në rrugë kishte vetëm dy makina të ndalura, me nga një burrë pranë. Njëri po u drejtonte revolen.

- Mos lëvizni, mos bëni asnjë lëvizje të dyshimtë. Duhet t'ju kontrollojmë.

Ua prekën trupat me lëvizje shumë të ashpra. Vajza u përpoq të fliste, ndërsa Pauloja ishte i ngrirë nga hutimi dhe paniku që e kishte kapluar sa vinte e shtoej. Hidhte sytë përreth mos kalonte dikush që të shihte se ç'po ndodhte dhe të njoftonte policinë.

- Mbylle gojën, kurvë, - thirri një nga burrat. Ua morën çantat, bashkë me portofolat dhe paratë; pastaj i shtynë dhe i futën, të ndarë, në vendet e pasme të dy makinave. Pauloja nuk pati kohën të shihte ç'po i ndodhte vajzës; në fakt as ajo nuk pati mundësinë të kuptonte ç'u bë me të dashurin. Në makinën e Paulos ishte edhe një burrë tjetër.

- Vëre këtë, - i tha dhe i zgjati një kapuç. - Shtrihu nën sedilje.

Pauloja u bind. Truri i tij nuk reagonte më. Makina u largua. Donte t'u thoshte se familjen e kishte në gjendje dhe do të paguante sado që të kërkonin, por fjalët nuk i dolën nga goja.

Makina u nis me shpejtësi.

Treni e uli shpejtësinë: me siguri po i afroheshin kufirit holandez.

- Je mirë, shoku? - pyeti argjentinasi.

Pauloja pohoi me kokë, duke kërkuar një argument të çfarëdoshëm për bisedë, për të namatisur mendimet e këqija. Kishin kaluar dy vjet nga episodi në Vila Velha, në përgjithësi arrinte t'i kontrollonte demonët që e mundonin. Por sa herë që përmendej ose i dilte përpara fjala “Policia” - qoftë edhe në uniformën e një punonjësi kufitar - e pllakoste tmerri në çast. Vetëm se këtë herë, bashkë me panikun u rikthye edhe ajo histori e vjetër. Ua kishte treguar disa miqve, duke mbajtur gjithmonë njëfarë distance nga ngjarjet, sikur ta vëzhgonte veten nga larg. Megjithatë, këtë herë - për të parën herë - historinë po ia tregonte vetes.

- S'ka problem edhe po të mos na lënë të kalojmë. Mund të shkojmë në Belgjikë dhe të hyjmë nga një pikë kufiri tjetër, - sugjeroi argjentinasi.

Pauloja nuk kishte më dëshirë të fliste - paranoja e kishte mbërthyer sërish. Po sikur argjentinasi

të merrej vërtet me trafik droge? Po sikur të mendonin se ishin bashkëpunëtorë dhe ta fusnin në burg? Si ta vërtetonte që ishte i pafajshëm?

Treni u ndal. Jo në doganë, por në një stacion të vogël në një zonë të shkretuar: zbritën pesë pasagjerë, hipën dy. Argjentinasi e kuptoi që Pauloja nuk ia kishte ngenë bisedës dhe e la në mendimet e veta; gjithsesi e vuri re sa i shqetësuar ishte - e tregonte qartë shprehja e fytyrës. E pyeti edhe një herë:

- Shoku, a je mirë?

- Po bëj një namatisje të vogël, të heq mendimet e këqija.

Argjentinasi e kuptoi situatën dhe nuk foli më.

Pauloja e dinte se atje, në Europë, nuk ndodhin gjëra si ato që kishte përjetuar në Brazil. Në fakt kishin ndodhur, por në të shkuarën. Një pyetje ia kishte bërë gjithmonë vetes: kur shkonin drejt dhomave të gazit, kur rrinin të rreshtuar përpara një varri të përbashkët, pasi kishin parë si i kishin pushkatuar shokët e rreshtit përpara tyre, si nuk reagonin ata njerëz, si nuk përpiqeshin të iknin apo të sulmonin ekzekutuesit e tyre?

Përgjigjja ishte e thjeshtë: paniku të mbërthen kaq fort sa të duket sikur nuk ndodhesh atje. Truri bllokohet - tmerri dhe frika zhduken, dhe njeriu i nënshtrohet rendit të pashmangshëm të ngjarjeve. Emocionet veniten dhe zhyten në njëfarë limboje: të gjitha këto ndodhin në një zone të trurit deri më sot të paekspluar. Shkencëtarët e kanë quajtur këtë

fenomen “skizofreni e përkohshme e shkaktuar nga stresi”, por nuk janë shqetësuar të analizojnë pasojat e vërteta të atij që e quajnë “flat affect”, njëfarë sheshimi të emocioneve.

Dhe, kështu, ndoshta për të dëbuar fantazmat e së kaluarës së tij njëherë e përgjithmonë, Pauloja e përjetoi atë ngjarje edhe një herë, deri në fund.

Burri në sediljen e pasme dukej më pak i egër se ata që e kishin ndalur në hotel.

- Mos u shqetëso, nuk do të të vrasim. Rri shtrirë

Pauloja nuk ishte i shqetësuar - thjesht truri nuk po përpunonte më asgjë. I dukej sikur kishte rrëshqitur në një realitet paralel; mendja e tij nuk e pranonte atë që po i ndodhte. Arriti të bënte vetëm një pyetje:

- A mund të mbahem te këmba jote?

- Sigurisht, - iu përgjigj burri. Atëherë Pauloja ia shtrëngoi mirë këmbën, ndoshta më fort nga ç'ishte nevoja: në fillim mendoj se mos e vriste, por ai tjetri nuk dha ndonjë shenjë bezdie. Ky e dinte mirë si ndihej Pauloja, ndoshta mund t'i vinte edhe keq teksa shihte një djalë të ri që kalonte një peripeci të tillë. Por urdhrat duheshin zbatuar.

Udhëtimi ishte i gjatë dhe sa më shumë kalonte koha, aq më shumë bindej se po e shpinin në vendin ku do ta ekzekutonin. I dukej sikur e kuptonte çfarë po ndodhte: e kishin marrë një grup oficerësh

paraushtarakë dhe tashmë konsiderohej i zhdukur. Veçse tani nuk kishte më rëndësi.

Makina u ndal. E zbritën me dhunë dhe e shtynë drejt një korridori. Duke ecur u pengua në dysheme: maja e këmbës i ngeci diku, ndoshta në një ristelë më të ngritur.

- Më ngadalë, ju lutem, - iu tha.

Si përgjigje mori goditjen e parë në kokë.

- Mbylle gojën, terrorist!

Ra në tokë. E urdhëruan të ngrihej, të hynte në dhomën përballë dhe të zhvishej, pa e hequr kapuçin. Ashtu bëri. Pastaj filluan ta rrihnin: pa e ditur nga i vinin goditjet, nuk mund ta përgatiste trupin për t'i pritur - nuk arrinte t'i kontraktonte muskujt. Kështu dhimbja bëhej gjithmonë e më e padurueshme, më e fortë se sherret që kishte bërë kur ishte më i ri. U shemb përsëri në dysheme dhe grushtet u zëvendësuan me shkelma. E rrahën pa pushim derisa një zë dha urdhër të ndaleshin.

Ishte ende i vetëdijshëm, por nuk ishte i sigurt a kishte ndonjë kockë të thyer, apo dëmtime të brendshme; nuk lëvizte dot nga dhimbjet. Zëri, që kishte ndalur të rrahurat, i tha të ngrihej. Pastaj i bëri një sërë pyetjesh për gueriljet, për bashkëpunëtorët, për arsyet e udhëtimit në Bolivi, për kontaktet me bandën e Che Guevara-s, për vendin ku kishin fshehur armët. E kërcënoi se do t'ia nxirrte sytë po të vërtetohej përfshirja e tij në organizata kryengritëse. Një zë tjetër, me sa duket i atij që në këto raste quhet

“polic i mirë”, e qetësoi dhe i sugjeroi të pranonte që kishte marrë pjesë në vjedhjen e një banke në atë zonë. Do ta arrestonin, sigurisht, por të paktën nuk do ta rrihnin prapë.

Në atë çast, ndërsa mundohej me vështirësi të mbahej në këmbë, filloi të dilte nga gjendja letargjike, ku ishte zhytur, dhe iu duk sikur përshqoi një grimë të asaj dhuntie që e kishte konsideruar gjithmonë thelbësore për njeriun; instinkti i mbijetesës. Duhej të dilte nga ajo situatë. Duhej të vërtetonte se ishte i pafajshëm.

E urdhëruan të tregonte çfarë kishte bërë gjithë javën e kaluar. U tregoi edhe hollësitë më të parëndësishme, ndonëse e dinte se burrat që kishte përballë nuk kishin dëgjuar ndonjëherë për Maçu Piçun.

- Mos mendo se po na e hedh duke marrë kohë, - i tha “polici i keq”. - E gjetëm hartën në dhomën e hotelit. Të kanë parë bashkë me atë vajzën në vendin e ngjarjes.

Harta?

Burri ia ngriti një cep të kapuçit dhe i tregoi vizatimin që i kishin dhënë në Kili, me udhëzimet për të kaluar vargmalin e Andeve.

- Komunistët mendojnë se do të fitojnë zgjedhjet e ardhshme. Se Allende-ja do të përdorë arin e Moskës për të korruptuar disa shtete të Amerikës së Jugut. E keni gabim: shumë gabim. Ç’rol ke ti brenda aleancës? Ç’kontakte ke në Brazil?

Pauloja tha se asgjë s'ishte e vërtetë. U tregoi se udhëtonte vetëm për të parë botën. Pyeti për të dashurën.

- Kush? Ajo spiunia e Jugosllavisë: një vend komunist që do të shkatërrojë demokracinë e Brazilit? Po i japim hakun edhe asaj, - iu përgjigj “polici i keq”.

E ndiente panikun që rritej, por bëri çmos ta mbante veten. Duhej të kuptonte si të dilte nga ai makth. Si të zgjohej.

Dikush i vuri një kuti me ca tela dhe një manivelë mes këmbëve. Një tjetër i tha që aparatin e quanin “telefon”: disa pllakëza metalike vendosen në trupin e të burgosurit, rrotullohet manivela për ta karikuar dhe aparati shkarkon energji elektrike kaq të fortë, sa “s’ka burrë nëne ta durojë”.

Kur pa aparatin, Pauloja e la qëndrimin e nënshtruar dhe ngriti zërin:

- Kujtoni se kam frikë? Kujtoni se më trembin dhimbjet? E keni gabim: torturohem vetë! Jam shtruar në çmendinë - jo një, po disa herë - e di mirë ç’janë dridhjet e korrentit. Megjithëse duhet ta dini vetë: me siguri e keni kaq informacion për mua.

Pas këtyre fjalëve i nguli thonjtë në mish, e gërvishtti lëkurën sa e bëri gjak, ndërsa bërtiste se ata dinin gjithçka, se mund edhe ta vrisnin - ç’i duhej atij, besonte në rimishërim dhe një ditë do të kthehej t’i kërkonte, do t’u vihej nga pas, atyre dhe familjeve, sapo të shkonte në atë botën tjetër.

Një burrë iu afrua dhe ia mbajti duart. Dukeshin të gjithë të trembur nga ajo sjellje, megjithëse s’kishin ndërhyrë për ta ndalur.

- Lëri këto, - i tha “polici i mirë”. - Si e shpjegon hartën?

Pauloja foli - me zërin e një të çmenduri. Me ulërima shpjegoi çfarë kishte ndodhur në Santiago dhe u tregoi për vizatimin e hartës me udhëzimet për të kaluar nga Kili në Argjentinë, përmes qafës së Cumbre-s.

- Po e dashura ime... ku është?

Tani po bërtiste edhe më fort, me shpresë se dikush do ta dëgjonte. “Polici i mirë” mundahej ta qetësonte (me sa duket, diktatura nuk ishte kaq e ashpër në ato vitet e para). I tha të mos dridhej më, të mos shqetësohej në rast se ishte vërtet i pafajshëm. Gjithsesi, përpara se ta lironin duhej ta verifikonin dëshminë e dhënë. Pra, do të qëndronte atje edhe njëfarë kohe. Nuk e saktësoi për sa kohë, por i zgjati një cigare. Pauloja vuri re se të tjerët po largoheshin nga dhoma: me sa duket nuk kishin më interes për të.

- Pasi të kem dalë edhe unë, kur të dëgjosh zhurmën e çelësit në bravë, mund ta heqësh kapuçin. Sa herë të dëgjosh që trokasin në derë do ta vësh prapë. Do të dalësh sapo t’i mbledhim të gjitha informatat që na nevojiten.

- Po, e dashura ime? - bërtiti edhe një herë Pauloja.

Ndërkohë mendonte se nuk e meritonte këtë që po i ndodhte. Sado që s’kishte qenë fëmijë i mbarë, sado që i kishte munduar prindërit, këtë nuk e meritonte.

Ishte i pafajshëm, por po të kishte një armë, do ta kishte zbrazur në vend mbi torturuesit e tij. S'ka gjë më të keqe se të ndëshkohesh për diçka që s'e ke bërë.

- Mos ki merak. Ne nuk jemi përbindështa përdhunues. Kemi detyrë të mbrojmë vendin tonë nga ata që e kanë vënë në rrezik.

Burri u largua dhe e tërhoqi fort derën. Pauloja dëgjoi kërcitjen e çelësit në bravë dhe hoqi kapuçin. Ndodhej në një dhomë me izolim akustik, me prapun e derës më të ngritur. Ja ku ishte penguar, kur e kishin shtyrë brenda. Në të djathtë ishte një pasqyrë e madhe - me siguri që nga krahu tjetër të shihnin çfarë ndodhte brenda dhomës. Në mur kishte dy-tri vrima plumbash: në njërën iu bë sikur pa edhe një fije floku, por e detyroi veten të mos reagonte. Pa me kujdes trupin dhe plagët që i kishte shkaktuar vetes; pastaj preku brinjët dhe kockat. Nuk kishte fraktura: me sa duket ishin mjeshtër në atë punë dhe nuk linin asnjë gjurmë të përhershme.

Me gjasa reagimi i tij i kishte befasuar dhe hamendësoi se tani do të kontaktonin me policinë e Rio-de-Zhanejros për të konfirmuar historinë e shtrimit në çmendinë, të terapisë me elektroshok, të zhvendosjeve gjatë udhëtimit dhe të historisë me të dashurën. Ndoshta do ta ndihmonte pasaporta jugosllave, ose përkundrazi, do ta fundoste pikërisht origjina nga një vend komunist.

Po të dilnin në përfundimin se kishte gënjyer, do ta torturonin vazhdimisht me ditë të tëra. Po të kishte

thënë të vërtetën, ndoshta do ta kuptonin se ishte thjesht një hipi i droguar, djali i një familjeje të pasur, dhe do ta lironin.

Nuk kishte gënjyer, prandaj dhe shpresonte se do ta kuptonin shumë shpejt.

Nuk e dinte sa kohë kishte kaluar në qeli - dritare nuk kishte dhe drita ishte gjithmonë e ndezur. Vetëm një njeri pa ato ditë: fotografën e qendrës së torturave. Mos ishte ndonjë kazermë? Komisariat policie? Burri i tha ta hiqte kapuçin, ia vuri aparatën fotografik përpara fytyrës, që të mos të mos dukej se ishte lakuriq, dhe e shkrepiti; pastaj e ktheu në profil, shkrepiti një fotografi tjetër, doli pa i thënë asnjë fjalë.

Edhe kur trokisnin në derë nuk kishte asnjë rregull që t'i lejonte të dallonte ndonjë rutinë: ndonjëherë mëngjesin ia sillnin pak përpara drekës - dy vaktet vinin pothuajse njëkohësisht - ndërsa darka vononte shumë. Për të shkuar në banjë trokiste në derë me kapuçin në kokë. I binte derisa rojat ta kuptonin se çfarë kërkonte, kryesisht duke e parë përmes pasqyrës. Kishte raste që mendohej të shkëmbente ndonjë fjalë me rojën, që e shoqëronte në banjë, por nuk merrte përgjigje. Vetëm heshtje.

E kalonte pjesën më të madhe të kohës duke fjetur. Një ditë - apo ishte natë? - vendosi t'i shfrytëzonte

orët e burgut për të medituar, apo për t'u përqendruar në një realitet më të lartë. Kujtoi fjalët e Shën Gjorit të Kryqit për natën e errët të shpirtit, murgjit që kalonin vite të tëra nëpër shpella në shkretëtirë, ose në malet e Himalajeve. Donte të ndiqte shembullin e tyre dhe ta shfrytëzonte atë përvojë të tmerrshme për t'u bërë njeri më i mirë. Ishte i bindur se e kishte denoncuar recepsionisti i hotelit. Ndonjëherë mendonte të shkonte ta vriste sapo të dilte nga burgu. Herë të tjera e bindte veten se do t'i shërbente më mirë Perëndisë po ta falte me gjithë shpirt, meqë ai nuk e dinte se ç'bënte.

Por falja është një art i vështirë për t'u praktikuar. Gjatë udhëtimeve, për t'u bërë njësh me universin, e kishte parë vetë sa të vështirë e kishte t'i duronte njerëzit kur e vinin në lojë për flokët e gjatë, kur e pyesnin kur ishte larë për herë të fundit, kur i vinin në dukje rrobat me ngjyra aq të ndezura - që tradhtonin pavendosmërinë e tij seksuale - kur e pyesnin me sa burra kishte fjetur, kur i thoshin ta linte drogën dhe të gjente një punë të mirë, të bënte edhe ai pjesën e vet për të nxjerrë vendin nga kriza ekonomike.

Urrejtja, që kishte për padrejtësinë, dëshira për hakmarrje dhe paaftësia për të falur nuk e linin të përqendrohej, kështu meditimin ia ndërprisnin mendime mizore - sipas tij të justifikuara. Shpesh pyeste veten a e kishin njoftuar familjen e tij.

Me siguri prindërit nuk ishin të shqetësuar për atë mungesë të tejzgjatur, meqë nuk e dinin kur kishte ndër

mend të kthehej. Për atë sjellje të pahijshme ia vinin fajin së dashurës njëmbëdhjetë vjet më të madhe, e cila e shfrytëzonte për disa nevoja që s' ishte me vend të përmendeshin, për të thyer rutinën e jetës së saj si socialiste e pakënaqur, si e huaj në vendin e gabuar, si manipuluese e djemve të rinj, që nuk digjeshin për të fejuara, por për gra që t'u zëvendësonin nënat - si të gjithë miqtë dhe të gjithë armiqtë e tij, për atë punë: si gjithë të tjerët në botë që jetonin jetën e tyre pa i shkaktuar probleme askujt, pa i detyruar familjet të shpjegonin jetën e tyre, që të mos i shihnin si njerëz që nuk kishin ditur t'i edukonin fëmijët. E motra e Paulos studionte Inxhinieri Kimike dhe ishte me rezultate të shkëlqyera, por krenaria e prindërve për të nuk ishte e mjaftueshme; kishin hall t'i gjenin një vend në botën e tyre.

Pas njëfarë kohe në qeli - e pamundur të llogaritet me saktësi - Pauloja filloi të mendonte se e meritonte gjithçka që po i ndodhte. Disa nga shokët e tij i ishin bashkuar rezistencës së armatosur duke e ditur se çfarë i priste, ndërsa ai thjesht po paguante pasojat - edhe pse nuk e kishte zgjedhur atë rrugë, edhe pa vepruar. Ky ishte dënim i ardhur nga qielli, jo nga njerëzit: për dhimbjen që kishte shkaktuar, e kishte hak të dergjej lakuriq në një qeli me tri vrima plumbash në mur, duke kthyer vështirimin thellë brenda vetes, pa gjetur asnjë grimë force, asnjë fije ngushëllimi, ose të paktën një zë që t'i fliste, si kishte ndodhur te Porta e Diellit.

Prandaj flinte aq shumë. Shpresonte të çlirohej nga makthi, por sytë i hapte në të njëjtën qeli, shtrirë në të njëjtën dysHEME. Mendonte se ia kishte hedhur më së keqes, por sërish zgjohej i mbuluar nga djersë të ftohta dhe sa binte dera e ngërthente paniku, i bindur se torturuesit e tij nuk kishin gjetur elemente që të vërtetonin ato që kishte thënë. E, atëherë, do ta torturonin edhe më shumë se herën e parë.

Dikush trokiti në derë - Pauloja sapo kishte ngrënë darkën, por e dinte se mund t'i sillnin mëngjesin për ta çorientuar edhe më shumë. Vuri kapuçin. Më pas dëgjoi zhurmën e derës që hapej. Hodhën diçka në dysHEME.

- Vishu. Kujdes mos heqësh kapuçin.

Ishte zëri i “policit të mirë”, ose “torturuesit të mirë”, si preferonte ta quante në mendimet e tij. Burri priti që Pauloja të vishej dhe të mbathte këpucët. Kur u bë gati, e mori për krahu dhe e kujtoi të bënte kujdes te pragu i derës: tashmë e mbante mend atë pengesë - kishte mësuar ta shmangte kur e shoqëronin në banjë - por iu duk sikur tjetri donte të tregonte njëfarë përkujdesjeje. Mendoj gjithashtu se plagët e vetme në trup i kishte bërë me duart e veta.

Pasi ecën rreth tri minuta, u dëgjua një zë tjetër:

- Varianti ju pret jashtë.

Varianti? Përpara se ta kuptonte se bëhej fjalë për modelin e makinës, hamendësoi se mund të ishte ndonjë kod sekret, që kishte kuptimin: “Toga e pushkatimit është gati”.

E shoqëruan në makinë. I dhanë një letër dhe një stilolaps. Nuk i ra ndër mend të lexonte: do të firmoste çdo gjë, edhe deklaratën ku pranonte krimin - të paktën do të dilte nga izolimi që po e çmendte. Por “torturuesi i mirë” e sqaroi se ishte lista e sendeve që i kishin sekuestruar në hotel. Çantat e shpinës ishin në bagazh. Çantat! Në shumës! Ishte kaq i hutuar sa nuk e vuri mbaresën.

U bind dhe firmosi. Në krahun tjetër të kopshtit u hap një derë: nga e qepura e kapuçit Pauloja dalloi një fustan me ngjyra: ishte ajo! Po i afrohej e shoqëruar nga një rojë. E urdhëruan të nënshkruante një letër, por ajo nuk pranoi; donte të lexonte çfarë ishte shkruar në atë dokument. Nga zëri dallohej se e kishte bërë zap panikun dhe se u kishte vënë fre mjaft mirë ndjenjave. Roja priti me durim që e reja të lexonte deri në fund. Pasi e lexoi vendosi firmën. Më pas preku dorën e Paulos.

- Nuk lejohet kontakti fizik, - tha “torturuesi i mirë”.

Ajo s’ia vuri veshin dhe, për një çast, Pauloja mendoi se do t’i kthenin në atë ferr për t’i dënuar për mosbindje. U përpoq t’ia largonte dorën, por ajo ia shtrëngoi edhe më fort. Hipën në makinë. “Tortuesi i mirë” thjesht mbylli derën dhe i dha urdhër shoferit të nisej. Pauloja e pyeti vajzën a ishte mirë, por mori si përgjigje një akuzë të gjatë për atë që kishte ndodhur. Nga sedilja përpara u dëgjua një e qeshur dhe ai iu lut

së dashurës të heshte: do të flisnin më vonë, ndoshta diku tjetër, atje ku po i shpinin - ndoshta në një burg të vërtetë.

- Nuk të japin të firmosësh një dokument ku thuhet se po t'i kthejnë sendet personale nëse nuk do të të lirojnë, - iu përgjigj ajo. Nga sedilja përpara u dëgjua një tjetër e qeshur, madje dy. Shoferi nuk ishte vetëm.

- Nuk thonë kot që gratë janë më të guximshme dhe më të zgjuara se burrat, - tha njëri prej tyre. - E kemi parë edhe me të burgosurit.

Tjetri i tha të mos fliste. Rruga zgjati edhe pak. Më pas makina u ndal dhe pasagjeri në krah të shoferit u tha t'i hiqnin kapuçat.

E njohu, ishte një nga burrat që i kishin ndalur në hotel; kishte tipare aziatike dhe këtë herë po buzëqeshte. Zbriti nga makina bashkë me ta, hapi bagazhin - mori çantat e shpinës dhe nuk i la në tokë, por ua dha në dorë.

- Jeni të lirë. Te kryqëzimi merrni majtas dhe ecni njëzet minuta, që të dilni në rrugën kryesore.

Hipi në makinë me shumë qetësi, sikur të mos kishte asnjë lidhje me ç'kishte ndodhur deri atëherë. Ky ishte Brazili tashmë: këta njerëz kishin marrë drejtimin e vendit, ishte e pamundur t'i denoncoje abuzimet.

Pauloja pa të dashurën, e cila ia ktheu shikimin. U përqaftuan dhe u puthën gjatë; pastaj morën drejt rrugës kryesore. Ai mendonte se ishte me rrezik po të qëndronin atje. Ndërsa për vajzën dukej sikur

s'kishte ndodhur asgjë, sikur ato ditë - apo javë, apo muaj - të kishin qenë vetëm një ndërprerje e udhëtimit që kishin ëndërruar shumë gjatë dhe ngjarjet të mos i kishin venitur kujtimet e lumtura. Pauloja ecte me hap të shpejtë dhe mundohej të mos ia vinte fajin vendimit të së dashurës: po të mos e kishin bërë devijimin për të parë skulpturat ranore, po të kishin vazhduar udhëtimin e tyre, asgjë nuk do të kishte ndodhur. Në të vërtetë, askush nuk kishte përgjegjësi për atë përvojë të tmerrshme - as ai, as e dashura, as tjetërkush. Shpejt e kuptoi se ato ishin mendimet e një personi të dobët dhe qesharak.

Papritur e kapi një migrenë e tmerrshme, një dhimbje koke kaq e fortë, sa e kishte të pamundur të ecte më, të kthehej në qytetin ku ishte rritur, apo të shkonte edhe një herë te Porta e Diellit për të pyetur perënditë e lashta për çdo gjë që kishte ndodhur. U mbështet në një mur dhe e la çantën të rrëshqiste në tokë.

- E kupton nga se e ke? - e pyeti vajza, dhe menjëherë shtoi: - Unë e di mirë, sepse e kam kaluar gjatë bombardimeve në Jugosllavi. Në burg aktiviteti cerebral dobësohet, sepse gjaku nuk qarkullon normalisht në deje dhe arterie. Pas disa orësh do të ndihesh, më mirë. Do të marrim ca aspirina nëse shohim ndonjë farmaci rrugës.

Pastaj hodhi çantën e Paulos në sup, e ndihmoi të ngrihej dhe e tërhoqi që të vazhdonin rrugën, në fillim ngadalë e pastaj me hap më të shpejtë.

Çfarë gruaje: e jashtëzakonshme! Sa keq që kur i propozoi të shkonin bashkë në *Piccadilly Circus* dhe në *Sheshin Dam* - dy qendrat e botës në atë kohë - ajo iu përgjigj se ishte e lodhur nga udhëtimet dhe se, në të vërtetë, nuk e donte më. Më mirë të vazhdonte secili në rrugën e vet.

Treni ndaloi. Nga dritarja dukej tabela ku shkruhej në disa gjuhë “Doganë”.

Disa policë hipën dhe filluan të lëviznin nëpër vagonë. Pas namatisjes, Pauloja ishte më i qetë, edhe pse i kthehej vazhdimisht ndër mend një varg i “Biblës”, nga Libri i Jobit: “Ajo që më tmerron më ndodh”.

Duhej ta mbante veten: frika nuhatet lehtë. Duhej të sillej normalisht. Nëse në rastin më të keq do t’i kthenin në kufi, si thoshte argjentinasi, s’ishte ndonjë problem i madh. Kishte pika të tjera kufitare për të hyrë në Holandë. Edhe po të mos kalonte, mbetej qendra tjetër e botës, *Piccadilly Circus*-i.

Pasi e përjetoi sërish tmerrin e disa viteve më parë, tani ndihej më i qetë. E kuptonte se ngjarjet duheshin përballuar pa frikë, si ndodhi të pashmangshme të jetës: nuk i kemi në dorë gjërat që na ndodhin, por mund ta zgjedhim vetë si të reagojmë. Më në fund ishte çliruar nga kanceri i padrejtësisë, i dëshpërimit dhe pafuqisë që i ishte përhapur si metastaza në tërë trupin e tij yjor.

Tani do t'ia niste nga e para.

Policët hynë në vagonin ku udhëtonin Pauloja, argjentinasi dhe katër të panjohur. Si pritej, policët u thanë të zbrisnin. Jashtë bënte ftohtë, edhe pse s'kishte rënë ende nata.

Në njëfarë mënyrë, shpirti i njeriut përsërit ciklin e natyrës: bimët lindin lulet që të tërheqin bletët, të cilat do t'i pjalmojnë dhe do t'i shndërrojnë në frutë. Këto fruta do të japin farërat, nga të cilat do të lindin bimë të tjera, që do të tërheqin tufa bletësh që t'i pjalmojnë, që kështu të rriten fruta të tjera - e kështu me radhë, në përjetësi. Mirë se erdhe vjeshtë, stina e mbarë për të lënë të vjetrën e për t'i hapur rrugën të resë.

Disa të rinj, ndoshta dhjetë veta, djem e vajza, i shoqëruan në mjediset e doganës. Asnjë nuk fliste. Pauloja bëri kujdes të ecte larg argjentinastit, i cili e vuri re manovrën dhe nuk e mundi më me praninë, apo bisedën e vet. Ndoshta e kishte kuptuar se braziliani kishte dyshime dhe po e gjykonte; por më pas vuri re se fytyra e Paulos tani ishte rrezatuese - ndoshta "rrezatuese" është e tepruar: gjithsesi, s'kishte gjurmë të trishtimit të mëparshëm.

Pasagjerët e zbritur nga treni thirreshin një nga një në një sallë të vogël, por askush s'e dinte çfarë ndodhte atje brenda, sepse i nxirrnin nga një derë tjetër. Paulon e thirrën të tretin.

Prapa një tavoline qëndronte ulur një burrë me uniformë: i kërkoi pasaportën; pasi e shfletoi, konsultoi një regjistër me emra.

- Kam ëndërr të shkoj... - nisi të thoshte Pauloja, por i bënë shenjë të heshte.

Rrahjet e zemrës iu shtuan, ndërkohë që mundohej ta mbante mendjen te vjeshta që po hynte, te gjethet e vyshkura që kishin filluar të binin dhe te njeriu i ri që po rilindte, ndryshe nga ç'kishte qenë, skllav i mijëra emocioneve të furishme.

Meqë vibracionet negative tërheqin të tjera edhe më të këqija, Pauloja e detyroi veten të qetësohej: madje u ndje më mirë sapo vuri re se polici i doganës kishte një vath në vesh, stoli e pamendueshme në çfarëdo vend tjetër. U përpoq ta hiqte mendjen duke hedhur sytë në dhomën e mbushur me dokumente; në mur binte në sy fotografia e mbretëreshës dhe një afishe me mullinjtë e famshëm me erë. Polici mbylli regjistrin dhe e shtyu në cepin e tavolinës. Më pas, pa u interesuar për arsyen e udhëtimit në Holandë, e pyeti Paulon a kishte parà për një biletë kthimi nga vendi ku vinte.

U përgjigj pozitivisht: i kishin thënë se ky ishte kushti bazë për të udhëtuar në çdo vend të huaj, prandaj kishte blerë një biletë shumë të shtrenjtë për në Romë, qyteti nga po vinte, ndërsa datën e kthimit e kishte caktuar pas një viti. I gatshëm për të vërtetuar deklaratën e sapobërë, u mat të nxirrte qeskën që fshihte në pantallona, lidhur me rripin, por polici i tha që s'kishte nevojë. Thjesht donte të dinte sa parà kishte.

- Rreth 1600 dollarë, - u përgjigj. - Ndoshta edhe diçka më shumë se nuk e llogarita sa shpenzova për trenin.

Kishte mbërritur në Europë me 1700 dollarë, fitimet e punës si mësues në kursin përgatitor për shkollën e teatrit që kishte ndjekur edhe ai vetë. Bileta më e lirë që kishte gjetur të shpinte në Romë: me të mbërritur në kryeqytetin italian kishte marrë vesh, gjithmonë falë “Gazetës” se vendtakimi i hipive ishte *Sheshi i Spanjës*. Natën flinte në park, rronte me panine dhe akullore; do të kishte qëndruar gjatë në Qytetin e Përjetshëm, edhe falë njohjes me një spanjolle nga Galicia, me të cilën u bënë fillimisht miq e më pas të dashur. Pastaj bleu kryeveprën e gjeneratës së tij, librin që do t’i ndryshonte jetën: “Europa me 5 dollarë në ditë”. Gjatë qëndrimit në *Sheshin e Spanjës* kishte vënë re se jo vetëm hipitë, por edhe shumë njerëz “kallëp”, si quheshin atëherë, e konsultonin librin ku ishin rreshtuar hotelet dhe restorantet më të lira, veç pikave turistike të shumë qyteteve. Po të shkonte në Amsterdam, nuk do të ndihej plotësisht i huaj. Prandaj, kur spanjollja i tha se donte të shkonte në Athinë, Pauloja vendosi të vazhdonte drejt pikëmbërritjes së tij të parapëlqyer - krahas *Piccadilly Circus*-it, si përsëriste sa herë që t’i jepej mundësia.

Kur u mat sërish të tregonte paratë, polici vuri vulën në pasaportë dhe ia ktheu. E pyeti nëse po fuste në Holandë bimë ose fruta. Po, kishte dy mollë: polici